



www.legjisllacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 24

Tiranë – E hënë, 22 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 4746, datë 9.8.2016	Për shprehje interesi, për shërbimin e konsulencës “Dizenjimi i specifikimeve teknike për fazën e dytë dhe të tretë të MIS të NE” 3



PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE (SAMP)

Tiranë, 8.8.2016

KËRKESË

Nr. 4746, datë 9.8.2016

PËR SHPREHJE INTERESI SHËRBIME KONSULENCE PËR DIZENJIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, PËR FAZËN E DYTË DHE TË TRETË TË MIS TË NE Ref. no. SAMP/CS/CQ/02-2015

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale
(SAMP)*

Hua nr. 8141- AL

Nr. i identifikimit të projektit: P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (shërbimi) përfshin, lokale, **“Dizenjimi i specifikimeve teknike për fazën e dytë dhe të tretë të MIS-së së NE-së”**.

Objekti i konsulencës është zhvillimi i Specifikimeve të Kërkesave të Sistemit (SRS), i cili do të përdoret si udhëzues kryesor për hartimin e mëvonshëm dhe zbatimin e fazës 2 dhe fazës 3 të Sistemit *software* të Menaxhimit të Informacionit (MIS), nën një përpjekje të veçantë konsulente. Konsulenti do të kryejë analizën dhe përcaktimin e proceseve të biznesit; do të përcaktojë kërkesat e hollësishme të përdoruesit; do të përcaktojë aktorë të ndryshëm, rolet dhe përgjegjësitë; do të përcaktojë të dhëna dhe menunë e procesit; do të kryejë analizën e të dhënave dhe modelimin; do të përcaktojë përdoruesit dhe ndërfaqet e sistemit dhe do të përcaktojë objektet e kërkuara të sistemit dhe komponentët, ndër të tjera. Proceset e biznesit dhe kërkesat specifike të përdoruesve do të përcaktohen duke përdorur UML-në ose metodologji të ngjashme të propozuara nga konsulenti. Përdoruesit dhe kërkesat specifike të sistemit dhe të gjithë procesit dhe objekte të projektimit të sistemit do të përcaktohen me anë të rasteve të detajuara të përdorimit (*Use Case*) dhe me diagramet e tjera UML.

Kjo konsulencë do të kërkojë një ekip të përbërë nga një analist i lartë i biznesit, me shtatë ose më shumë vite përvojë në procesin e analizës funksionale (proceset e biznesit, kërkesat funksionale, menu, rrjedhën e të dhënave, analizën e të dhënave etj.) dhe një anëtar të dytë, një analist i lartë i të dhënave me shtatë ose më shumë vite përvojë në analizën e të dhënave, modelimin e të dhënave, menaxhimin e të dhënave. Dy anëtarët e ekipit duhet të plotësojnë këto kushte:

Kualifikime akademike:

- Diplomë universitare në nivelin master në shkencë kompjuterike, menaxhimin e informacionit, administrim biznesi apo në të tjera të lidhura ngushtë.

Eksperiencë teknike:

- Të paktën 7 vjet përvojë të dëshmuar të veçantë në analizat e kërkesave të sistemeve informative, kërkesave të biznesit, kërkesave të përdoruesit, kërkesat *software*, kërkesat e *hardware*-ve, kërkesat për lidhje (*interface*);

- Të ketë zhvilluar specifikimet dhe kërkesa të *software*-ve, duke përdorur e duke qenë familjar me standardin IEEE 830;

- Njohuri dhe eksperiencë të gjerë në zhvillimin, dokumentimin dhe livrimin e “UML Use Cases”, “Class diagrams”, “Sequence diagrams” etj.;

- Të ketë prodhuar specifikime sistemesh dhe *software*-sh për sisteme të mëdha të madhësisë që përfshijnë bazat e të dhënave masive, trajtimin e një milion të dhënave apo më shumë, qoftë në sektorin publik apo privat;

- Të ketë përvojë të gjerë me “System Development Life Cycle” dhe të ketë përdorur metodologji të zhvillimit “objekt-orientuar”, të jetë i njohur me JAD-në dhe metodologji e mjete të ngjashme.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP), fton të gjitha kompanitë e konsulencës legjitime (konsulente), të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Kriteret e vlerësimit teknike (kriteret e shortlistimit) janë:



	KRITERET	MAX. PIKËT
1	Eksperiencë në “ <i>System Development Life Cycle</i> ”, të fokusuar në zhvillimin e specifikimeve të kërkesave të <i>software</i> -ve për sistemet e menaxhimit të informacionit, me përmasa të mëdha	40
2	Njohuri dhe eksperiencë në inxhinierinë e sistemeve të informacionit, me analiza, dizenjim dhe zbatim të MIS-ve për ndërmarrje të mëdha	20
3	Eksperiencë në projekte të ngjashme në sektorin publik, duke punuar për një organizatë ndërkombëtare	20
4	<i>Background</i> i përqendruar akademik në shkenca kompjuterike, menaxhimin e informacionit ose administrim biznesi, të fokusuar në sistemin e analizave dhe të projektimit	20
TOTAL		100

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore, në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe bua të IDA-së & Grante nga huamarrësit e Bankës Botërore* (“Udhëzuesi i konsulentëve”, version i janarit të 2011-s).

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një *joint venture* apo në formën e nënkontraktimit për të rritur kualifikimet e tyre.

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është “Përzgjedhje sipas kualifikimit të konsulentit” - CQ, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimin e konsulentëve (botim i janarit 2011).

Konsulenti pritet të fillojë shërbimin në shtator 2016 dhe afati i shërbimit përlloritet rreth 8 javë.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00, të premtën.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri më **29 gusht 2016**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Rruga e Kavajës, nr. 53, Tirana, ALBANIA

Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli

e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016